

1 E hënë, 9 nëntor 2020

2 [Paraqitja e Parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Thaçi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Ju
7 uroj mirëseardhje të gjithëve në sallë dhe jashtë sallës së
8 gjyqit.

9 Përpara se të fillojmë, në përputhje me vendimin për
10 caktimin e datës së kësaj seance, fotografi ka të drejtë të
11 bëjë fotografi për një minutë e gjysmë. Përpara se të filloni,
12 ju lutem të mos fotografoni z. Thaçi me rojat e sigurisë në
13 sfond. Faleminderit.

14 Faleminderit. Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit.

15 Z. Sekretar i Gjykatës, ju lutem paraqitni lëndën.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita. Kjo është
17 lënda numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër
18 Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
19 Krasniqit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit Sekretar.

21 Përpara se t'u kërkoj të pranishmëve që të prezantohen,
22 dua t'ju rikujtoj të gjithëve për rregulla që duhet të
23 respektohen gjatë gjithë kohës në mënyrë që seanca të
24 zhvillohet pa pengesa.

25 Ju lutem ndizeni mikrofonin përpara se të flisni dhe

1 fikenit kur të përfundoni me të folur. Ju faleminderit.

2 Flisni ngadalë dhe qartë, meqë ajo që thuhet përkthehet
3 në shqip dhe në serbisht.

4 Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni mua, ose
5 një pale apo pjesëmarrësi, në mënyrë që përkthyesit të kenë
6 kohë të përfundojnë përkthimin.

7 Ajo që thuhet në këtë seancë transkribohet në kohë reale
8 dhe do të reflektohet në një procesverbal i cili do t'u vihet
9 në dispozicion palëve dhe publikut mbas kësaj seance.

10 Gjithashtu, dua t'i kujtoj palët se një pjesë e
11 informacionit në këtë çështje është objekt i urdhrave për masa
12 mbrojtëse dhe konfidencialitet. Këtu përfshihet informacioni
13 konfidencial që është redaktuar nga Aktakuza e Konfirmuar,
14 përkatësisht, informacioni që lidhet me identitetin e disa
15 individëve, me data, vendndodhje dhe informacion tjetër
16 identifikues.

17 Gjithashtu, dua t'i rikujtoj të gjithë se informacioni
18 konfidencial nuk nxirret në seancë të hapur. Në qoftë se një
19 palë apo pjesëmarrës dëshiron të hyjë në seancë private për
20 t'iu referuar një informacioni konfidencial, këtë duhet ta
21 bëjë të qartë dhe t'i paraqesë arsyet.

22 Tani do t'u kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
23 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të
24 Specializuar.

25 Z. Prokuror urdhëroni.

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar Gjykatës.

2 Mirëdita.

3 Zyra e Prokurorit të Specializuar sot përfaqësohet nga
4 Prokurori i Specializuar, z. Jack Smith; Zëvendësprokurori i
5 Specializuar, z. Alex Whiting; shefja e Njesisë për Çështje
6 Ligjore, Clare Lawson; prokurori, David Harbach; dhe unë
7 Prokuror i Lartë, Alan Tieger.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Tani i drejtohem Mbrojtjes.

10 Z. HOOPER: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës. Unë
11 jam David Hooper. Jam anëtar i Shoqatës së Avokatëve të
12 Anglisë dhe Uellsit dhe kam nderin të përfaqësoj z. Hashim
13 Thaçi sot pasdite. Sot më ndihmon znj. Sophie Menegon e
14 Shoqatës së Avokatëve të Parisit. Disa prej kolegëve të mi nuk
15 ishin në gjendje të jenë të pranishëm këtu, për arsye që i
16 dimë të gjithë, por unë do t'i përmend. Avokati, z. Pierre
17 Prosper që besoj se është në San Francisko; avokati nga
18 Kosova, z. Pallaska në Prishtinë; z. John Greenblatt, që është
19 në Uashington; dhe plot të tjerë që na ndihmojnë.

20 Është me keqardhje që them se ky proces është realizuar
21 pa e njoftuar Mbrojtjen në kohën e duhur. Unë dua ta bëj të
22 qartë qëllimin tim se do të bashkëpunoj me Gjykatën, ashtu siç
23 ka bërë edhe vetë z. Thaçi gjatë gjithë këtyre viteve dhe
24 gjatë periudhës së themelimit të kësaj Gjykate. Gjykata po i
25 heton këto çështje për pesë vjet e më shumë, kurse ju e keni

1 Aktakuzën së paku para gjashtë muajsh.

2 Ne për herë të parë mësuam për këto çështje, për
3 realizimin e tyre, për mendimin tim ishte të mërkurën në
4 mbrëmje, apo të enjten. Pra, me fjalë të tjera, nuk ishte e
5 mundur që të themelohet, të krijohet një ekip mbrojtës, nuk
6 ishte e mundur që të sjellim këtu njerëz që dëshironin të
7 ishin të pranishëm në këtë seancë dhe për -- nga ana jonë
8 është e pakuptimtë dhe e kemi të vështirë faktikisht ta
9 kuptojmë sepse kjo është bërë në këtë mënyrë. Dua të them edhe
10 më shumë lidhur me këtë në kohën e duhur.

11 Tani i nderuar Gjykatës, unë -- i nderuar Gjykatës, unë
12 do të ulem dhe do t'ju lejoj që të vazhdoni me kryerjen e
13 detyrave tuaja si Gjykatës i Procedurës Paraprake.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dua gjithashtu për hir të
15 procesverbalit të them se është i pranishëm në sallë edhe z.
16 Thaçi.

17 Tani i drejtohem Administratores. Urdhëroni.

18 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës.
19 Unë jam Fidelma Donlon, Administratore.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për hir të procesverbalit,
21 unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake në
22 këtë çështje.

23 I akuzuari paraqitet sot për herë të parë para Dhomave të
24 Specializuara, pas një Aktakuze të Konfirmuar kundër tij.

25 Z. Thaçi, ju lutem ngrihuni në këmbë.

1 A mund, ju lutem, të na e thoni emrin dhe mbiemrin?

2 I AKUZUARI THAÇI: Hashim Haxhi Thaçi.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vendi i lindjes dhe data e
4 lindjes?

5 I AKUZUARI THAÇI: Kosovar, 24 prill 1968.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Thaçi.
7 Mund të uleni.

8 Tani do të kaloj te historiku procedural i kësaj
9 çështjeje.

10 Më 26 tetor 2020, unë si Gjykatës i Procedurës Paraprake,
11 konfirmova Aktakuzën e parashtruar nga Prokurori i
12 Specializuar kundër të akuzuarit ku përmbahen gjashtë akuza
13 për krime kundër njerëzimit, përkatësisht, për përndjekje,
14 burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, dhe
15 zhdukje me forcë e personave, dhe katër akuza për krime lufte,
16 përkatësisht, për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë, dhe
17 vrasje të paligjshme.

18 I akuzuari u arrestua në Kosovë më 5 nëntor 2020 dhe u
19 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të
20 Specializuara në Hagë po atë ditë.

21 Z. Thaçi, përpara se të vazhdojmë dua të sigurohem që
22 mund t'i ndiqni procedurat në një gjuhë që e kuptoni dhe
23 flisni. A mund, ju lutem, të më konfirmoni se kuptoni dhe e
24 flisni gjuhën shqipe?

25 I AKUZUARI THAÇI: Po.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

2 Me konfirmimin tuaj jam i bindur se mund t'i ndiqni
3 procedurat në gjuhën shqipe si gjuhë që e kuptoni dhe e
4 flisni, në përputhje me rregullën 92 të Rregullores së
5 Procedurës dhe të Provave. Në qoftë se në ndonjë moment gjatë
6 kësaj seance nuk mund ta ndiqni përkthimin, atëherë ju lutem
7 të ma bëni me dije menjëherë.

8 Tani më lejoni t'ju shpjegoj qëllimin specifik të seancës
9 të Paraqitjes së Parë për nevojat e të akuzuarit dhe atyre
10 që na ndjekin nga galeria e publikut dhe online.

11 Seanca e sotme nuk është gjykim. Nuk do të paraqiten
12 prova e as nuk do të debatohen prova. Fajësia ose pafajësia e
13 të akuzuarit nuk do të diskutohet, dhe në lidhje me të nuk do
14 të merret vendim në këtë seancë. Qëllimi i kësaj seance
15 rregullohet me nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92 të
16 Rregullores. Sipas këtyre dispozitave, unë si Gjykatës i
17 Procedurës Paraprake, kam për detyrë që:

18 t'ia lexoj të akuzuarit akuzat e përfshira në Aktakuzën e
19 Konfirmuar në një gjuhë që ai e kupton dhe flet;

20 të konfirmoj që i akuzuari e kupton Aktakuzën;

21 të bindem se të drejtat e të akuzuarit, dhe veçanërisht e
22 drejta e tij për mbrojtës, janë respektuar;

23 të informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga data e
24 sotme ai do të ftohet të vetëdeklarohet lidhur me fajësinë ose
25 pafajësinë për secilën pikë të paraqitur në Aktakuzë. Në qoftë

1 se i akuzuari dëshiron, ai mund edhe menjëherë të
2 vetëdeklarohet për fajësinë ose pafajësinë.

3 Dhe në fund, do të caktoj datat e tjera, sipas nevojës,
4 gjatë kryerjes së detyrës time si Gjykatës i Procedurës
5 Paraprake.

6 Pres prej palëve që t'u përmbahen këtyre çështjeve që do
7 t'i trajtojmë një nga një. Në qoftë se ndonjëra prej palëve do
8 që të diskutojë ndonjë çështje që nuk është përfshirë në
9 kuadrin e kësaj Paraqitjeje të Parë, ftoj atë palë që këtë ta
10 bëjë me shkrim, me anë të parashtrimeve me shkrim.

11 Së pari, z. Thaçi, a mund të më konfirmoni se e keni
12 marrë Aktakuzën e Konfirmuar të datës 4 nëntor 2020 në gjuhë
13 që e flisni dhe e kuptoni?

14 I AKUZUARI THAÇI: Po.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Thaçi.

16 Tani do t'i kërkoj Sekretarit të Gjykatës që t'i lexojë
17 akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar sikurse
18 parashikohet në nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në Aktakuzën e
20 Konfirmuar, Prokurori i Specializuar akuzon Hashim Thaçin për:

21 Pika 1: Përndjekje, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm
22 në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

23 Pika 2: Burgosje, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm
24 në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

25 Pika 3: Ndalim arbitrar, krim lufte i ndëshkueshëm në

1 bazë 14(1)(c) të Ligjit;

2 Pika 4: Akte të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit
3 i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

4 Pika 5: Trajtim mizor, si krim lufte i ndëshkueshëm në
5 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

6 Pika 6: Torturë, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm në
7 bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

8 Pika 7: Torturë, krim lufte i ndëshkueshëm në bazë të
9 nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

10 Pika 8: Vrasje si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm
11 në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;

12 Pika 9: Vrasje e paligjshme, si krim lufte i ndëshkueshëm
13 në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit; dhe

14 Pika 10: Zhdukje me forcë e personave, si krim kundër
15 njerëzimit i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(i) të Ligjit.

16 Këto krime u kryen midis afërsisht prillit 1998 dhe
17 gushtit 1999, në një numër vendndodhjesh në Kosovë dhe në
18 Shqipërinë veriore, ndër të cilat:

19 Bare, Bajgorë, Llapashticë, Majac, Potok dhe vende të
20 tjera në komunën e Podujevës; Drenoc dhe vende të tjera në
21 komunën e Rahovecit; Malet e Berishës, Llapushnik dhe vende të
22 tjera në komunën e Drenasit; Ferizaj dhe vende të tjera të
23 komunës së Ferizajt; Gjilan në komunën e Gjilanit; Jabllanicë
24 në komunën e Gjakovës; vendndodhje në komunën e Kaçanikut; dhe
25 vende të tjera në komunën e Lipjanit; Likoc dhe vende të tjera

1 në komunën e Skënderajt; Malishevë dhe vende të tjera në
2 komunën e Malishevës; në Shpellën e Volljakës në komunën e
3 Klinës; Novobërdë në komunën e Novobërdës; Zllash dhe vende të
4 tjera në komunën e Prishtinës; Prizren dhe vende të tjera në
5 komunën e Prizrenit; Suharekë dhe vende të tjera në komunën e
6 Suharekës; dhe vendndodhje në komunën e Vitisë; dhe

7 Në Cahan dhe Kukës në Shqipërinë veriore.

8 Krimet në pikat 1, 2, 4, 6, 8 dhe 10 u kryen si pjesë e
9 një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik të drejtuar
10 kundër popullatës civile në Kosovë dhe në Shqipërinë veriore,
11 duke filluar prej së paku marsit '98 deri në shtator të vitit
12 '99. Në veçanti, këto krime kishin në shënjestër kundërshtarët
13 të cilët perceptoheshin se: (i) kishin bashkëpunuar, ose
14 kishin lidhje me forca, zyrtarë, ose institucione shtetërore
15 të Republikës Federale të Jugosllavisë, ose (ii) ndryshe, nuk
16 përkrahnin qëllimet dhe metodat e Ushtrisë Çlirimtare të
17 Kosovës, (UÇK), dhe më pas të Qeverisë së Përkohshme të
18 Kosovës, duke përfshirë edhe persona që kishin lidhje me
19 Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe persona të përkatësisë
20 etnike serbe, rome, dhe të tjera.

21 Krimet në pikat 3, 5, 7 dhe 9 u kryen kundër personave që
22 nuk merrnin pjesë aktive në luftime, dhe në kontekstin e dhe
23 në lidhje me konfliktin e armatos jondërkombëtar në Kosovë
24 midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë,
25 ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore

1 dhe njësitet të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe
2 grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë, nga
3 së paku marsi i vitit '98-të e deri më afërsisht 16 shtator
4 1999.

5 Në lidhje me këto krime, ekziston dyshim i bazuar mirë se
6 z. Thaçi është penalisht përgjegjës në bazë të nenit 16(1) (a)
7 të Ligjit për:

8 a. kryerjen, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të
9 përbashkët, të krimeve në pikat 1 deri në 10, ose në
10 alternativë, kryerjen e ndërmarrjes kriminale të përbashkët të
11 lartpërmendur të krimeve në pikat 1 deri në 10, duke qenë i
12 vetëdijshëm se këto krime mund të kryheshin gjatë zbatimit të
13 qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të përbashkët,
14 dhe duke e ndërmarrë këtë rrezik me vullnet të lirë; dhe/ose

15 b. ndihmimin dhe inkurajimin e krimeve në pikat 1 deri në
16 10.

17 Gjithashtu dhe në alternativë, ekziston dyshim i bazuar
18 mirë se z. Krasniqi //siç u përkthye// është penalisht
19 përgjegjës, në bazë të nenit 16(1) (c) të Ligjit, si epror për
20 krimet në pikat 1 deri në 10.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.
22 Sekretar i Gjykatës.

23 Z. Thaçi, dëshiroj t'ju kujtoj se sot nuk është koha të
24 kontestoni akuzat, por thjesht të pranoni që i kuptoni akuzat.
25 Do të keni mundësi të bollshme t'i kundërshtoni akuzat me

1 ndihmën e avokatëve tuaj.

2 Z. Thaçi, a i kuptuat akuzat që përmbahen në Aktakuzën e
3 Konfirmuar siç i lexoi Sekretari i Gjykatës?

4 I AKUZUARI THAÇI: I kuptova. I dëgjova dhe i kam lexuar
5 dhe i hedh poshtë të gjitha.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Thaçi.

7 Tani t'ju njoftoj për të drejtat tuaja para kësaj
8 Gjykate.

9 Ligji i Dhomave të Specializuara dhe Rregullorja e
10 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë një numër të drejtash.
11 Do t'ju lexoj më të rëndësishmet.

12 Së pari, ju prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e
13 fajësinë përtej dyshimit të arsyeshëm;

14 Në përcaktimin e akuzave kundër jush, keni të drejtë për
15 gjykim të drejtë dhe publik në varësi të masave që mund të
16 urdhërohen për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve;

17 Keni të drejtë që të njoftoheni menjëherë dhe në hollësi,
18 në një gjuhë që e kuptoni, për natyrën dhe arsyet e akuzave
19 kundër jush;

20 Keni të drejtën të keni kohë dhe lehtësi të mjaftueshme
21 për përgatitjen e mbrojtjes tuaj dhe të komunikoni me avokatët
22 që i keni zgjedhur vetë;

23 Keni të drejtën të gjykoheni brenda një kohe të
24 arsyeshme;

25 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe të

1 mbroheni përmes avokatëve tuaj;

2 Keni të drejtën t'ju caktohet avokat dhe pa pagesë në
3 qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për të paguar për
4 mbrojtjen;

5 Keni të drejtën t'i bëni pyetje, ose që dikush t'u bëjë
6 pyetje në emrin tuaj dëshmitarëve dhe të kërkonit paraqitjen
7 dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emrin tuaj;

8 Keni të drejtën të ndihmoheni pa pagesë nga një
9 përkthyes, në qoftë se nuk e kuptoni ose flisni gjuhën që
10 përdoret në Gjykatë;

11 Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër
12 vetes, ose të pranoni fajësinë;

13 Keni të drejtën të qëndroni në heshtje dhe nuk do të
14 nxirret asnjë përfundim negativ nga heshtja juaj;

15 Po kështu, keni të drejtën të bëni deklaratat pa betim në
16 lidhje me çështjen dhe mund të paraqiteni si dëshmitar nën
17 betim;

18 Po kështu, keni të drejtën të bëni mocione paraprake për
19 të kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, për
20 të pretenduar të meta në formën e Aktakuzës dhe për të kërkuar
21 ndarjen më vete të Aktakuzës;

22 Keni të drejtën të merrni brenda 30 ditësh nga seanca e
23 sotme materialet mbështetëse të Aktakuzës që është dorëzuar
24 për konfirmim;

25 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e

1 dëshmitarëve që ka ndërmend të thërrasë Prokurori i
2 Specializuar që të dëshmojnë në gjyq, në një gjuhë që e
3 kuptoni dhe e flisni, pra, në shqip;

4 Keni të drejtën të merrni menjëherë çfarëdo informacioni
5 që mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme pafajësinë tuaj,
6 ose të zbusë fajësinë tuaj, ose që ndikon në besueshmërinë e
7 provave të Prokurorit të Specializuar, sapo ky informacion të
8 jetë në ruajtjen, kontrollin apo dijeninë e tij;

9 Keni të drejtën që të gjitha materialet ose faktet që
10 disponon Prokurori i Specializuar, t'ju vihen në dispozicion
11 para sesa të fillojë procesi dhe gjatë procesit. Kjo e drejtë
12 kufizohet vetëm nëse është rreptësisht e nevojshme, ose kur
13 zbatohen masa mbrojtëse balancuese;

14 Keni të drejtën që të mos mbaheni i paraburgosur për një
15 periudhë kohore të paarsyeshme para hapjes së çështjes
16 gjyqësore. Të kërkonit rishikimin e vendimit për paraburgim dhe
17 të bëni apel kundër këtyre vendimeve drejtpërsëdrejti para
18 Gjykatës së Apelit;

19 Keni të drejtën të bëni apel drejtpërsëdrejti para
20 Gjykatës së Apelit për një vendim të mocioneve paraprake që
21 kundërshtojnë juridiksionin e Dhomave të Specializuara;

22 Keni dhe të drejtën të kërkonit leje për të apeluar
23 vendime të tjera.

24 Z. Thaçi, i dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që
25 gëzoni në pajtim me kornizën ligjore të Dhomave të

1 Specializuara. A i kuptoni këto të drejta?

2 I AKUZUARI THAÇI: Po.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Thaçi.

4 Dua t'ju informoj që në bazë të nenit 21(5) të Ligjit, ju
5 nuk mund të përfaqësoni veten, sepse tashmë jeni i
6 paraburgosur. Përfaqësimi nga Mbrojtësi i Specializuar është i
7 detyrueshëm.

8 Është detyra ime si Gjykatës i Procedurës Paraprake të
9 siguroj që të drejtat tuaja për avokat janë respektuar. Për
10 këtë kam marrë shënim parashtrimin e Administratores që më
11 informon për emërimin e avokatit.

12 Avokat, a mund të konfirmoni që jeni emëruar për të
13 përfaqësuar z. Thaçi?

14 Z. HOOPER: [Përkthim] Po, konfirmoj.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, jam i bindur dhe i
16 kënaqur që i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi.

17 Tani do t'i kthehem mundësisë që i akuzuari të
18 vetëdeklarohet në përputhje me nenin -- me rregullën 92.

19 Z. Thaçi, brenda 30 ditësh nga data e sotme do të
20 thirreni për të pranuar fajësinë, ose të vetëdeklaroheni i
21 pafajshëm për secilën prej pikave të Aktakuzës së Rishikuar --
22 të Konfirmuar.

23 Në qoftë se dëshironi, mund të vendosni që menjëherë të
24 pranoni fajësinë, ose të vetëdeklaroheni i pafajshëm.

25 Pra, desha t'ju pyes z. Thaçi, nëse keni pasur mundësi

1 t'i diskutoni akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar me avokatin
2 tuaj, dhe nëse jeni i përgatitur apo i gatshëm të
3 vetëdeklaroheni sot. Në qoftë se doni ta bëni këtë, do t'ju
4 ftoja që të ngriheni në këmbë kur të vetëdeklaroheni.

5 I AKUZUARI THAÇI: I nderuari Gjykatës, akuza është krejt
6 e paqëndrueshme dhe deklarohej i pafajshëm plotësisht.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Thaçi.

8 A mund të konfirmoj që po vetëdeklaroheni i pafajshëm për
9 të gjitha pikat e Aktakuzës?

10 I AKUZUARI THAÇI: Ritheksoj, akuza është krejt e
11 paqëndrueshme. Deklarohem i pafajshëm për të gjitha pikat e
12 akuzës si të paqëndrueshme. Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Thaçi.

14 Atëherë të kaloj tani te gjuha e punës e këtyre
15 procedurave.

16 Në urdhrin për mbajtjen e kësaj seance, unë i kërkoja
17 palëve që të bënim parashtrime në lidhje me gjuhën e punës në
18 këtë rast, në bazë të rregullës 8.

19 Z. Prokuror, ju e thatë sot në mëngjes pozicionin tuaj,
20 por a mund ta përsërisni për të akuzuarin.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit. Ne jemi të mendimit
22 që gjuha e punës duhet të jetë anglishtja.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. HOOPER: [Përkthim] Po nuk do të çuditeni besoj që edhe
25 ne nuk kemi kundërshtim për këtë.

1 Z. Thaçi flet pak anglisht, megjithatë do të ketë nevojë
2 për ndihmën e përkthyesit për të përkthyer në shqip.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Patjetër.

4 Z. HOOPER: [Përkthim] Edhe për dokumentet sigurisht.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të lëshoj një urdhër për
6 këtë më vonë.

7 Siç e kam thënë në urdhrin për Paraqitjen e Parë, unë do
8 të caktoj një datë për Konferencën për Ecurinë e Çështjes
9 sipas rregullës 96. Qëllimi është për të parë ku është statusi
10 i çështjes dhe të bëhen shkëmbime midis palëve për t'u
11 përgatitur sa më shpejt për gjykim.

12 Z. Thaçi, dua t'ju kujtoj se keni të drejtën që të merrni
13 pjesë në Konferencën për Ecurinë e Çështjes me avokatin tuaj,
14 por me lejen tuaj, pëlqimin tuaj me shkrim dhe pasi të keni
15 marrë këshilla nga avokati, kjo Konferencë për Ecurinë e
16 Çështjes mund të ndiqet nga ju në person, ndërsa avokati merr
17 pjesë me videolidhje, nga avokati juaj, kurse ju z. Thaçi mund
18 të merrni pjesë me lidhje me video, ose mund të kryhet edhe në
19 mungesën tuaj z. Thaçi, me avokatin tuaj që është i pranishëm,
20 ose që merr pjesë përmes videolidhjes.

21 Tani do t'i kërkoj palëve mendimet e tyre për një datë të
22 përshtatshme për Konferencën e Ecurisë së Çështjes, për t'u
23 mbajtur më datë 18 nëntor, ose mbas asaj date.

24 Dhe për Mbrojtjen, a mund të na thoni se a keni në plan
25 të merrni pjesë në person apo me videolidhje, dhe cili avokat

1 do të marrë pjesë. Kjo është thjesht në mënyrë që ne të
2 organizojmë videolidhjen me avokatë të ndryshëm në këtë
3 çështje.

4 Po së pari, z. Prokuror.

5 Z. TIEGER: [Përkthim] Siç kemi thënë më herët, Prokuroria
6 është në dispozicion kur të dojë Gjykata, dhe data e sugjeruar
7 është e përshtatshme për ne.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper.

9 Z. HOOPER: [Përkthim] Në emër të Mbrojtjes, dhe do të jem
10 unë kryesisht si mbrojtësi kryesor që kam ndërmend të ndjek të
11 gjitha seancat. Ndryshe nga Prokuroria ne kemi dizavantazhe që
12 shkaktohen nga KOVIDI dhe gjeografia. Dhe duke pas parasysh
13 organizimet që duhet të bëjmë, kërkesën p.sh., që disa palë të
14 marrin viza për të ardhur dhe për të qenë këtu, jo thjesht
15 vetëm për avokatët, po do të sugjeroni datën 30 nëntor.

16 Po në qoftë se më lejoni të marr fjalën përsëri në mënyrë
17 që të krijoj një lloj konteksti për këtë, se për -- çfarë po
18 kërkojmë nga ju për këto shtatë javët e ardhshme.
19 Faleminderit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të merrni një urdhër për
21 caktimin e datave që do të përfshihet në programin e punës më
22 vonë. Ne për shkak të kornizës ligjore jemi pak të kufizuar
23 nga afatet, sidomos për nxjerrjen e dokumenteve, dhe prandaj
24 është shumë e vështirë për të pasur një vonesë të tillë në
25 Konferencën për Ecurinë e Çështjes. Po do të përpiqemi t'ju

1 akomodojmë sa më shumë dhe brenda kornizës së procesit të
2 nxjerrjes së dokumenteve.

3 Unë, siç e thashë sot në mëngjes, do t'i kërkoj Zyrës së
4 Prokurorit të Specializuar që të dorëzojë parashtime me
5 shkrim deri më 13 nëntor dhe Mbrojta do të dorëzojë përgjigjen
6 e saj ndaj parashtimeve të Prokurorisë në ditët e ardhshme.

7 Dhe pas kësaj Konference për Ecurinë e Çështjes, do të
8 lëshoj një vendim për detyrimet e nxjerrjes së materialeve nga
9 Prokurori i Specializuar, sipas rregullës 102, dhe regjimin e
10 redaktimeve për këto procedura. Dhe kjo është një -- ky është
11 një hap i rëndësishëm për Mbrojtjen, sepse kjo është ajo që do
12 t'ju mundësojë ju t'i merrni të gjitha materialet provuese.

13 Në këtë moment desha t'u kërkoj palëve nëse keni ndonjë
14 çështje tjetër që doni të ngrini, dhe i kujtoj palët që të
15 njoftojnë paraprakisht nëse ndonjë nga parashtimet do të
16 kërkojë nxjerrjen e informacioneve konfidenciale në mënyrë që
17 të merren masat e duhura.

18 Z. Prokuror.

19 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk kemi asgjë më tej i nderuar
20 Gjykatës.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtja.

22 Z. HOOPER: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës që
23 më kërkuat të trajtoj dhe çështje të tjera brenda kufizimeve
24 të asaj që është e pranueshme në këtë fazë.

25 Ju, i nderuar Gjykatës, ju jeni marrë me Aktakuzën, ka

1 nja gjashtë muaj që po merreni me të dhe kjo është hera e parë
2 që dëgjoni nga Mbrojtja për këto çështje.

3 Z. Thaçi, u vetëdeklarua jofajtor për të gjitha pikat e
4 akuzave në këtë Aktakuzë. Dua ta bëj të qartë se ai është -- e
5 kundërshton të gjithë narrativën e kësaj Aktakuze të paraqitur
6 nga Prokuroria. Sigurisht ne jemi në dijeni sepse që në
7 qershor Prokurori e ka deklaruar që ju ka dorëzuar një
8 Aktakuzë, megjithëse ishte e pazakontë pak dhe ndoshta ishte
9 hap i gabuar, por ata e bënë njoftimin dhe tani e kemi
10 Aktakuzën, megjithëse është tejet e redaktuar dhe nuk është aq
11 informues dhe aq tregues për ne si Mbrojtje sa do të ishte në
12 qoftë se do të ishte hequr censura.

13 Megjithatë, kur e shikojmë Aktakuzën, Mbrojtja thotë
14 këtë: Ku janë aktakuzat për vjedhjen e organeve dhe për atë
15 shtëpinë e verdhë? Sepse faktikisht kjo ishte akuza apo
16 pretendimi --

17 Përkthimi është i gabuar. A mund të vazhdoj? Gjuha është
18 gabim, përkthimi është gabim.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Që ta kuptojmë, është
20 problem teknik?

21 I AKUZUARI THAÇI: [Përkthim] Jo është problemi i gjuhës.

22 Z. HOOPER: [Përkthim] Do të përpiqem --

23 I AKUZUARI THAÇI: [Përkthim] Është në thelb jo në
24 teknikë.

25 Z. HOOPER: [Përkthim] Atëherë për përkthyesit. Ne duhet

1 të -- nuk kam çfarë të bëj për këtë.

2 I AKUZUARI THAÇI: [Përkthim] Duhet kosovar.

3 Z. HOOPER: Ndoshta mund të flas më ngadalë dhe do ta bëj
4 këtë.

5 Pra, të përsëris pjesën që po thoja këtu për përkthyesin.
6 Po ngrija këtë çështje, dhe është një çështje e rëndësishme
7 dhe unë e di që njerëzit në Kosovë do t'i kushtojnë shumë
8 vëmendje kësaj: Ku janë këto pretendime për vjedhjen e
9 organeve, sepse këto ishin shumë të rëndësishme në lidhje me
10 lindjen e kësaj Gjykate?

11 I AKUZUARI THAÇI: [Përkthim] Përsëri është gabim. Më
12 falni.

13 Z. HOOPER: [Përkthim] Do të flas ngadalë, po zakonisht
14 unë flas shumë ngadalë.

15 Ku janë -- hera e tretë pra. Ku janë pretendimet për
16 vjedhjen e organeve njerëzore dhe historia e shtëpisë së
17 verdhë, e cila ishte kaq e rëndësishme në nxitjen për krijimin
18 e kësaj gjykate? Duke ndjekur, siç e dimë, atë gjysmë faqe
19 dramatike në librin e Carla del Pontes dhe që u ndoq pastaj
20 nga raporti i Dick Marty-t. Dhe në këto pretendime, jo vetëm
21 që është një njollë mbi Kosovën dhe kosovarët, por ishte edhe
22 pretendimi -- ky pretendimi që krijoi këtë Gjykatë të Kosovës.

23 Unë e them "Gjykatë e Kosovës", por nuk ka asgjë këtu nga
24 Kosova, nuk ka asnjë emblemë të Kosovës. Ndoshta mund t'i
25 kushtohet një vëmendje kësaj. Në qoftë se është Gjykatë e

1 Kosovës, mund të kishim këtu shqiponjën e zezë me të kuqe.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Po mund të kishit veshur
3 teshat kosovare, të kishit veshur tesha të kuqe.

4 Z. HOOPER: [Përkthim] Unë nuk jam anëtar i Shoqatës --
5 Odës së Avokatëve të Kosovës, kështu që kjo është e
6 rëndësishme d.m.th., që ta sjellim kostumin tonë në Gjykatë.

7 Pra, këto pretendime z. Thaçi i dinte gjepura, dhe duke e
8 ditur që ishin gjepura, ai ndihmoi Komisionin Evropian në
9 krijimin e kësaj Gjykate. Dhe ne dëgjojmë që ai mund të mos
10 kishte qenë shumë bashkëpunues, po nuk mund të jesh më
11 bashkëpunues sesa të jesh mamia e cila është aty e pranishme
12 në lindjen e kësaj Gjykate.

13 Pra, asgjë në këtë Aktakuzë nuk flet për vjedhjen e
14 organeve dhe ato krimet e tmerrshme që u pretenduan. Në vend
15 të kësaj ne kemi një përmbledhje incidentesh në Aktakuzë të
16 veprave penale dhe të ngjarjeve, shumë prej të cilave janë
17 gjykuar në TPNJ-në, në gjykatën -- Tribunalin Penal
18 Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ose në gjykatat e Kosovës
19 të vendosura në Kosovë. Dhe për ta përmbledhur, dhe të gjitha
20 këto së bashku kanë krijuar një -- i kanë vendosur në këto
21 akuza një strukturë të komandës.

22 Këto pretendime do të tregohen gjatë procesit të gjykimit
23 që janë falso. Ato do të luftohen fuqimisht dhe unë pres që
24 t'i luftojmë me sukses.

25 Ne, siç e kam treguar edhe më parë, u çuditëm që ju e

1 gjykuat të nevojshme të urdhëroni arrestimin e z. Thaçi, në
2 vend që të bëhej me anë të një fletëthirrjeje. Kjo u bë pas
3 parashtimeve që kishte bërë Prokuroria. Ne nuk i kemi këto
4 parashtime dhe unë kam ndërmend që të kërkoj sot pasdite
5 lirimin e tij të përkohshëm -- të ndërkohshëm, dhe besoj që
6 jua kam shprehur këtë mendim timin që të shtunën.

7 Por, mbasi kam menduar më gjatë, ne mendojmë që nuk është
8 e përshtatshme që të bëhet kjo kërkesë pa e ditur se çfarë
9 pretendon Prokuroria se është rreziku i arratisjes. Këtë, ai
10 është këtu, kështu që këtë sugjerim mund ta heqim. Po mesa
11 duket ju menduat që ai ishte rrezik për arratisje.

12 Por çështja e dytë që merret me ndërhyrjen. Unë nuk e di
13 se cilat janë pretendimet që mbështesin konkluzionin se ka
14 pasur ndërhyrje. Ne duam të dimë këtë në *aude* -- sipas parimit
15 *audi partem*. Ne duam të dimë se cilat janë praktikabilitetet e
16 këtij -- e kësaj kërkesë. Ne duhet ta dimë se çfarë po thuhet.

17 Në fakt ne kemi dhënë -- ne duam të marrim elementet
18 specifik të informacionit, përveç materialit mbështetës që ka
19 paraqitur Prokuroria pas 26 gushtit, që të dimë se cilat janë
20 ato pika.

21 Dhe po kështu do të kërkoj që kërkesa për lirim të
22 përkohshëm të bëhet në javët e ardhshme, mbasi të kemi marrë
23 këtë informacion dhe -- me gojë kur të jem unë këtu i
24 pranishëm. Kjo Gjykatë, ndryshe nga gjykata të tjera, merret
25 me parimet e paraqitjes gojore të gjërave. Kjo është diçka që

1 besoj do të ma jepni, të ma jepni mundësinë mua që z. Thaçi të
2 jetë këtu, të dëgjojë argumentet nga Prokuroria dhe pastaj
3 edhe nga Mbrojtja, në mënyrë që edhe ai të jetë i informuar
4 plotësisht për to.

5 Pra, pyetja që ngremë ne, është pyetje shumë e
6 rëndësishme: A e meriton ky person të mbahet i paraburgosur
7 këtu apo jo, duke pasur parasysh edhe prezumimin nga kjo
8 Gjykatë që prezumohet liria përveç rasteve kur ka disa arsye
9 për të justifikuar paraburgimin.

10 Pra, ndërkohë, duke pas parasysh që për gjashtë muaj
11 Prokuroria ju ka pëshpëritur në vesh, unë e mendoj që është e
12 përshtatshme që të them disa fjalë për Hashim Thaçin, i
13 nderuar Gjykatës, që unë mund ta paraqes këtu si një njeri me
14 integritet dhe ndershmëri, një person që i ka shërbyer vendit
15 të tij në luftë dhe në paqe, një burrë që ka arritur shumë dhe
16 nuk i meriton këto pretendime.

17 Në fakt një ditë më përpara mu dha një libër dhe unë nuk
18 dua që të flas unë me fjalët e mia, por dua t'i referohem
19 librit që kam përpara, në veçanti për faktin që Prokurori --
20 Zyra e Prokurorit vepron në mënyrë uniforme dhe dua të citoj,
21 dua të citoj librin e Bob Dolit //origj. Bob Dole//. Dhe besoj
22 që Bob Dolin e njihni të gjithë, është një senator i njohur
23 amerikan edhe ka qenë dhe kandidat për president në Amerikë,
24 dhe në kohën kur kandidatë të tillë respektoheshin nga të
25 gjithë. Z. Dole ka thënë si më poshtë, edhe do të doja t'i

1 referohesha një paragrafi të shkurtër që kam përpara këtu në
2 libër. Ai thotë:

3 "Kosova ka kaluar një rrugëtim vërtet të pabesueshëm dhe
4 një person ka qenë veçanërisht kritik, shumë i rëndësishëm për
5 këtë bastion demokracie në Ballkan, dhe ky person është Hashim
6 Thaçi. Si burrë i ri, pa mbushur ende 30 vjeç, ai ka qenë
7 drejtuesi i delegacionit kosovar në Rambuje, në Konferencën e
8 Rambujesë në Francë. Thaçi erdhi në tryezë si person i
9 panjohur, por deri në fund të konferencës, dy javë pas
10 fillimit të konferencës, ai u njoh si zëri i arsyes në një
11 kohë kur vërtetë kishte fraksione shumë të mëdha
12 brendapërbrenda vendit dhe fati i kombit mbështetej tek
13 aftësia e Thaçit për të bindur patriotët e tjerë dhe personat,
14 luftëtarët e tjerë. Dhe me thënë të drejtën, kjo nuk është se
15 ishte një detyrë e thjeshtë për të realizuar ndërkohë që
16 patriotët e tjerë luftonin në zona beteje kundër serbëve."

17 Pra, thjesht kjo ishte për të ilustruar atë çfarë thuhet
18 për z. Thaçi dhe sa i takon edhe pjesës së luftës kosovare.

19 Pra, është z. Thaçi, Hashim Thaçi, i cili doli mbi këtë
20 luftë si zëri i arsyes, pra, nga fatkeqësi dhe gjenocid i
21 jashtëzakonshëm që ishin shkaktuar nga Serbia, dhe ishte
22 pikërisht ai personi i cili e çoi vendin drejt pavarësisë dhe
23 ndihmoi po ashtu për të formësuar vendin që kemi sot, që është
24 një vend i ri, vibrant, është shumë kulturor, është shumë
25 fetar, mbështetës ndaj feve të ndryshme, tolerant. Dhe

1 ndërkohë që deri javën që shkoi, atij i kërkohej që të linte
2 pas të shkuarën dhe të gjente gjuhën e pajtimit me serbët.

3 Ndërkohë kam edhe një tjetër citim që është edhe më i
4 shkurtër sesa citimi që thashë më parë, por mendoj që është
5 goxha i fortë. Sipas këtij citimi thuhet:

6 "Hashim Thaçi është George Washington-i i Kosovës."

7 Dhe këtë e ka thënë Joe Biden, Zëvendëspresidenti
8 amerikan në vitin 2017 dhe kandidat për President i Shteteve
9 të Bashkuara sot.

10 Po i them këto fjalë dhe nuk është se dua të jem më i
11 mirë seç duhet, po është fillimi i një balance, i një
12 baraspeshe, ekuilibri. Ndërkohë që, z. Gjykatës, është detyra
13 jote që -- detyra e gjyqtarëve të tjerë të cilët të gjejnë një
14 balancë, apo të gjejnë të vërtetën dhe të thotë se ku qëndron
15 kjo e vërtetë. Megjithatë, këto janë hapat e parë, hapa të
16 vegjël fillestarë, por shpresoj që me kalimin e kohës
17 reputacioni i këtij personi do të vendoset në vend.

18 Më duhet të them që isha vërtet i çuditur kur u futa nga
19 ajo dhomë, që e shikoi zotërinë me pranga, të lidhur me
20 pranga. Është për të ardhur turp. Ju nuk jeni organ ndëshkimi,
21 nuk besoj që është kështu. Dhe besoj që -- dhe shpresoj që të
22 bëhet diçka për ta trajtuar këtë dhe të mos e ulni dinjitetin
23 e një personi deri në një pikë të tillë.

24 I nderuar z. Gjykatës, përmenda që nga ana ime do të isha
25 mirënjohës në qoftë se do të kishim seanca me gojë sa i takon

1 çështjes së lirimit të përkohshëm, të ndërmjetëm. Pa diskutim
2 që do të japim informacionin e nevojshëm sa i takon
3 depozitimeve që mund t'ju jenë dërguar para jush, i nderuar
4 Gjykatës. Dhe më lejoni të them që unë aktualisht gjendem
5 shumë larg nga këtu, pra, selinë e kam larg nga këtu, edhe siç
6 e thashë, angazhimi im është i tillë që një datë në qoftë se
7 do të ishte përpara datës 13 nëntor, do të ishte e vështirë
8 për mua për t'u ndierë edhe kjo nuk do të ishte në favorin e
9 z. Thaçi në qoftë se unë nuk do të isha këtu. Kështu që
10 shpresoj që anëtarë të tjerë të Mbrojtjes, apo qoftë edhe të
11 Prokurorisë të jenë mirëkuptues lidhur me këtë gjë.

12 Pra, sa i takon Konferencës së Statusit apo të gjendjes
13 gjyqësore, pra, do të ishte mirë që të planifikonim këtë
14 seancë në këto periudha kohore që thashë.

15 Z. Gjykatës, ju jam shumë mirënjohës për kohën e dhënë në
16 dispozicion dhe faleminderit që më dëgjuat të gjithë.
17 Faleminderit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë kemi një çështje
19 shumë të rëndësishme që e përmendët dhe ju, fakti që duhet të
20 keni akses, duhet të keni qasje në shumë prova dhe procese,
21 procedime, dhe për këtë arsye na duhet që të kemi proces të
22 nxjerrjes së informacioneve sa më shpejt të jetë e mundur, në
23 mënyrë që ju të keni akses në dosjet të cilat janë përgatitur
24 përpara arrestimit të klientit tuaj.

25 Pra, besoj që Prokuroria do të thotë diçka.

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Po. Në qoftë se më lejoni, dua që
2 t'ju drejtohem dhe unë z. Gjyqtar.

3 Së pari, në lidhje më të drejtpërdrejtë me çështjen e
4 ngritur prej jush, pse është pozicioni ynë, pse është qëndrimi
5 ynë që përmes arrestimit Mbrojtja është në pozicionin që të
6 trajtojë çështje të cilat kanë çuar në urdhërarrestin. Dua të
7 them që ka qenë synimi ynë që të ofrojmë një version të duhur
8 të censuruar, apo të redaktuar, të aplikimit, ose kërkesës për
9 kërkesë për arrest edhe shpresojmë që do t'ju japim të gjitha
10 informacionet deri në fund të javës.

11 Neve mezi presim që t'i përgjigjemi në detaje çdo
12 parashtrese me shkrim që ka të bëjë me bazën për ndalimin, apo
13 faktorët që do të dua të merren parasysh nga Gjykata për të
14 identifikuar dhe për të vlerësuar po ashtu rrezikun për
15 integritetin e proceseve gjyqësore, sigurinë e viktimave,
16 dëshmitarëve dhe personave të tjerë, dhe do ta trajtojmë -- do
17 t'i trajtojmë të gjitha këto çështje në detaje. Pra, nga
18 çështje të cilat tradicionalisht përfshihen në vlerësime të
19 tilla, si p.sh., natyra apo serioziteti i akuzave të ngritura,
20 disponueshmërisë e burimeve dhe rrjeteve për të lehtësuar
21 ndërhyrjet apo -- të cilat çojnë në çështje të tilla, të cilat
22 hedhin dritë mbi rrezikun e mundshëm të ndërhyrjes, përfshirë
23 këtu edhe ngjarjet apo aktivitetet e kohëve të fundit, si
24 p.sh., faktin që z. Thaçi ditën e fundit fare pra, përpara
25 sesa të fillonte procesi i arrestit, u informuam për faljen e

1 dy personave të cilët ishin dënuar për vrasjen e një
2 bashkëpunëtori të pretenduar që nga viti 2001, që ishin dënuar
3 në 2012 dhe pastaj ishin larguar, pra, ishin larguar në
4 drejtim të paditur për një periudhë kohore. Pra, këto janë
5 çështje të cilat do të trajtohen në detaje dhe ashtu siç duhet
6 në procesin gjyqësor dhe në varësi të parashtimeve orale, ose
7 gojore të cilat do të bëhen.

8 Mendoj që duke lexuar plotësisht, është e nënkuptuar se
9 në fakt bëhet fjalë për një Aktakuzë që përfshin pika të shumë
10 e shumë vrasjeve, dhe ajo çfarë dëgjojmë neve në fakt është që
11 z. Thaçi nuk është përgjegjës për këto. Në fakt, secila prej
12 akuzave, pikave në Aktpadi dhe ngjarje të cilat janë pjesë e
13 Aktakuzës, janë pjesë e mandatit, bien nën fushën e mandatit
14 të këtij Tribunali, kësaj Gjykate, dhe sigurisht që këto janë
15 çështje të cilat ne do t'i mbulojmë, do t'i shqyrtojmë, do t'i
16 diskutojmë gjatë procesit gjyqësor.

17 Së fundi, sa i takon dëshmive të ofruara nga Mbrojtja, të
18 gjithë personat të cilët janë këtu në Gjykatë sot, unë do t'u
19 thosha atyre, ashtu siç bëjmë edhe në rrethana të tjera që:
20 Zotëri në kohën kur juve e dhatë atë deklaratë, a keni qenë i
21 ndërgjegjshëm për provat nga shumë e shumë persona, nga
22 anëtarë të familjeve të personave të viktimave të cilët kanë
23 humbur jetën, sa i takon përgjegjësisë së personit për të
24 cilin ju po flisni dhe të cilin ju mbroni? Dhe sigurish që kjo
25 është një çështje të cilën ne do ta trajtojmë dhe do ta

1 shqyrtojmë gjatë procesit gjyqësor të kësaj lënde.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

3 Zoti avokat, doni të thoni diçka?

4 Z. HOOPER: [Përkthim] Jo. Dua të them vetëm kaq:

5 Sa i takon aplikimit, ose parashtimit për lirim të
6 përkohshëm, duke pasur parasysh natyrën e ligjeve, pra, ligjet
7 thonë që ndalimi është përjashtim, kështu që për këtë arsye
8 është e përshtatshme për Prokurorin, për Prokurorinë që të më
9 lërë mua, apo t'ju lërë juve z. Gjykatës që të kenë argumentet
10 e veta dhe ne të përgjigjemi me argumentet tona. Faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.
12 Mbrojtës.

13 Dua të trajtoj edhe një çështje të cilën e përmendët ju
14 z. Hooper, sa i takon prangave. Nuk ka trajtim të posaçëm për
15 klientin tuaj. Kjo është procedura që ne e aplikojmë mbi çdo
16 person që vjen këtu në dhomën, ose në sallën e gjyqit.

17 Tani do të doja t'i jepja fjalën Administratores, e cila
18 ndoshta mund të thotë diçka lidhur me praktikat e
19 institucionit që kanë të bëjnë me këtë element.

20 ADMINISTRATORJA: Faleminderit i nderuar z. Gjykatës.

21 Për të theksuar atë çfarë tha Gjyqtari i Seancën
22 Paraprake, më lejoni të them që procedura normale e shoqërimit
23 të të akuzuarve në sallën e gjyqit duhet që të përdorin pranga
24 deri në momentin kur futen në sallë. Kështu që nuk ka ndonjë
25 ndryshim për procedurën pavarësisht se kush është personi që

1 del përpara kësaj Gjykate.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. HOOPER: [Përkthim] Kam përshtypjen që z. Thaçi
4 dëshironte të thoshte diçka. Një moment ju lutem.

5 [Avokati mbrojtës konsultohet me të akuzuarin]

6 Z. HOOPER: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

7 Kishte të bënte në thelb me reflektimet edhe sa i takon
8 le të themi, këtyre dy personave që u përmendën nga Prokurori,
9 nga Prokuroria. Është thjesht çështje historie.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Dhe tani do të doja që t'i jepja edhe njëherë fjalën
12 Prokurorisë.

13 Z. TIEGER: [Përkthim] Ndoshta e kam keqkuptuar
14 parashtresën e fundit të Mbrojtjes. Në qoftë se avokati
15 mbrojtës po sugjeronte që dëshiron më shumë informacion sa i
16 takon parashtrimeve, parashtrësve fillestare të cilat
17 përfunduan me ndalimin e z. Thaçi, këto i trajtuam.

18 Por ai po thotë që duhet të ndryshojë urdhri i provës dhe
19 se ai dëshiron që të ndryshojë le të themi, forma e ndalimit.
20 Dhe në qoftë se kjo është kërkesa, në qoftë se e kuptova drejt
21 z. Mbrojtës, atëherë ne jemi kundër kësaj, në përputhje me
22 jurisprudencën e të gjithë institucioneve *ad hoc* dhe pas
23 logjikës së akuzës së ngritur në përgjithësi.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

25 Z. Hooper.

1 Z. HOOPER: [Përkthim] Sa më vjen në mendje, nuk njoh
2 ndonjë juridiksion që është kundër një individi që të kërkojë
3 lirim me kusht dhe nuk di që të ekzistojë ndonjë juridiksion
4 që është në kundërshtim të kësaj gjëje.

5 Dhe duke pasur parasysh urdhrin tuaj, urdhrin bazuar në
6 të cilin është arrestuar z. Thaçi, me aq sa e kuptoj unë, unë
7 personalisht do të thosha që juve nuk na keni dëgjuar për
8 parashtimet e bëra përpara se të arrestohej z. Thaçi. Kështu
9 që po them që do të ishte e drejtë që ne të dëgjonim
10 fillimisht se cili është pozicioni i Prokurorisë në mënyrë që
11 ne mund të reagojmë dhe të bëjmë parashtresat e duhura përpara
12 Gjykatësit, dhe të bësh të kundërtën në fakt është në
13 kundërshtim me frymën, me shpirtin e ligjit. Pra, i takon
14 Prokurorisë që të na tregojë që ata i përmbushin kriteret. Dhe
15 për këtë arsye mendoj që duhet të vijojmë sipas asaj çfarë unë
16 thashë deri tani. Kjo nuk i ndalon ata p.sh., që si palë
17 iniciuese, filluese të procedurës që të japi një përgjigje të
18 parashtresave, por mendoj që kjo është mënyra e duhur për të
19 vepruar.

20 Kaq kisha për të thënë.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se Gjykata
22 dëshiron që të dëgjojë më shumë prej nesh. Mendoj që kjo është
23 çështje e parashtresave me shkrim, por e vërteta dhe realiteti
24 është që Prokuroria ka bërë parashtime dhe Gjykata e ka marrë
25 vendimin dhe Mbrojta tani dëshiron që të kemi një ndryshim të

1 këtij kushti. Pra, ne e kuptojmë që mbrojtësi ka kërkuar
2 informacion nga ne lidhur me përmbajtjen e parashtresave të
3 mëparshme. Dhe sërish, për të dytën herë, më lejoni të them
4 dhe më lejoni të theksoj që ne parashikojmë që t'ia japim këtë
5 informacion së shpejti.

6 D.m.th., duket sikur po flasim më kot, sikur -- do t'ia
7 japim informacion dhe ne do të vijojmë më tej mbi bazën e të
8 gjitha parashikimeve.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

10 Mendoj se i kemi dëgjuar palët për këtë çështje, për këtë
11 lëndë dhe do të dëgjojmë për parashtresat lidhur me këtë
12 çështje.

13 Z. Thaçi, dua t'ju kërkoj juve, dua t'ju pyes në qoftë se
14 keni ndonjë gjë për të thënë lidhur me arrestimin, me
15 transferimin dhe me ndalimin tuaj në Hagë?

16 I AKUZUARI THAÇI: Gjithçka që do të theksoja e potencoi
17 avokati.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.
19 Thaçi.

20 Së fundi, dua t'ju informoj që do të nxjerr një vendim që
21 e urdhëron Prokurorin e Specializuar edhe Administratoren që
22 të riklasifikojë dosjet, ose të prodhojë versione të
23 pacensuruara sipas rastit, në mënyrë që ju këto informacione
24 t'i keni sa më shpejt të jetë e mundur.

25 Ndërkohë që vazhdoni të jeni në ndalim z. Thaçi, do të

1 doja që t'ju informoja që ju mund të kundërshtoni ndalimin në
2 përputhje me rregullën 57, dhe kjo do të trajtohet, siç u
3 përmend nga avokati juaj mbrojtës, në javët që do të vijjnë.

4 Në qoftë se palët nuk kanë gjë tjetër për të thënë, kemi
5 ardhur në fund të procesit të ditës së sotme.

6 Faleminderit të gjitha palëve, Administratores.
7 Faleminderit gjithashtu edhe përkthyesve, stenografëve,
8 personave me pjesën audiovizive, personelin e sigurisë edhe të
9 gjithë ata që kanë kontribuar për këtë seancë.

10 Ky është fundi i seancës. Faleminderit.

11 --- Seanca e Paraqitjes së Parë përfundon në
12 orën 16.05

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25